



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR

Nr. 852 Prot.,

Tiranë, më 12.01.2024

Lënda: Kthim përgjigje letrës së hapur të Rrjetit "SafeJournalists"

Drejtuar: Anëtarëve të Rrjetit "Safejournalists" dhe organizatave partnere të Reagimit të Shpejtë për Lirinë e Medias (MFRR), si dhe Reporterëve pa Kufij

Të nderuar përfaqësues të medias,

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) e vlerëson komunikimin që keni ndërmarrë me institucion tonë dhe përpjekjen tuaj për mbrojtjen e lirisë dhe integritetit të gazetarëve në kontekstin e mbrojtjes së interesit publik. Konsiderata juaj mbi nevojën e ligjshmërisë së proceseve gjyqësore, duke përfshirë këtu edhe rastet e përfshirjes së gazetarëve në shkelje ligjore, është në përputhje të plotë me filozofinë e ndjekur nga ne për hetimin e këtij rasti dhe ndaj çdo subjekti tjetër nën juridiksionin e SPAK.

Siç edhe është bërë e ditur në njoftimin tonë për shtyp të datës 14.12.2023, veprimet që lidhen me kontrollet ndaj z. Qyno dhe mjetet e sekuestruara prej tij, janë kryer në zbatim të ligjit dhe vetëm pasi është marrë një vendim gjykate për to. Cilësojmë gjithashtu se z. Qyno ka publikuar të dhëna që përbëjnë sekret hetimor. Qëllimi i daljes së këtyre të dhënave në publik nuk e justifikon arsyen e "informimit të publikut". Publikimi i këtyre të dhënave pengon drejtësinë, intimidon bashkëpunëtorët e drejtësisë, informon krimin e organizuar dhe mbi të gjitha rrezikon rendin dhe sigurinë publike. Nënvizojmë së nxjerrja në publik e këtyre të dhënave në kundërshtim me ligjin mund të rrezikojë rëndë jetën e personave të pafajshëm dhe punonjësve të agjencive ligjzbatuese.

Ne besojmë se nuk mund të ketë informim të publikut duke kryer krim dhe duke penguar organet e drejtësisë për të luftuar krimin e organizuar. Do të ishte cënim i rëndë i integritetit dhe figurës së profesionit të respektuar të gazetarit që të abuzohet me imunitetin profesional për tu përballur me drejtësinë.

Ne e vlerësojmë maksimalisht faktin që z. Qyno ka ndjekur të gjitha hapat ligjor, duke paraqitur pretendimet e tij përpara gjykatës kompetente, duke i dhënë atij mundësinë që të kontrollojë respektimin e të drejtave nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.

Nënvizojmë se SPAK e konsideron median një aleat të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të tij kushtetues në luftën pa kompromis kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë dhe krimit të organizuar.


SPAK fton anëtarët gazetar të rrjetit tuaj të nderuar që të mbështesin institucionin tonë në sensibilizimin e shoqërisë dhe komunitetit të gazetarëve për të denoncuar dhe për tu distancuar nga të gjitha format e keqpërdorimit të medias dhe kapjes së gazetarëve nga krimi i organizuar dhe zyrtarët e korruptuar.

Ju sigurojmë se kjo çështje po vlerësohet nga ana jonë me një kujdes maksimal dhe në përputhje të plotë me ligjin. Duke vlerësuar interesimin tuaj për ta sjellë këtë rast në vëmendjen tonë, shpresojmë në mirëkuptimin tuaj për qëndrimet tona në zgjidhjen ligjore të kësaj çështjeje.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Altin Dumani'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE' at the top, 'PROKURORIA SHQIPTARE KUNDËR KORRUPSIONIT TË ORGANIZUAR' around the perimeter, and 'TIRANË' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.